



Prishtinë, 31 mars 2016
Kodi i ZRRE: V_798_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafin 2.6 dhe 2.16, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregulla për vendosjen e çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut (Rregulla për Çmimet të OST/OT);
- Vendimi nr. V_518_2013 për Të Hyrat Maksimale Të Lejuara (MAR) për periudhë rregullative shume vjeçare që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut SHA (KOSTT);
- Aplikacionin e KOSTT-it të dorëzuar me datën 20 janar 2016, në kuadër të Shqyrtimit Dhjetë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE10) me dokumentacionin relevant sqarues.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur më 31 mars 2016 nxori këtë:

VENDIM

I. APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR) që do të mbulohen nga **Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut SHA (KOSTT)** përmes tarifave dhe ngarkesave për vitin relevant tarifar SHTE10.

ARSYETIM

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga KOSTT-i aplikacionin për aprovim të Hyrave të Lejuara Maksimale që duhet mbledhur nga OST/OT përmes tarifave dhe ngarkesave të rregulluara.


Në marrjen e vendimit të tij për MAR që do të mbulohet nga OST/OT, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet si në vijim që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:

- Vlerësimi përfundimtar, Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës (KOSTT sh.a.), i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
- Vlerësimi përfundimtar- Pasqyrë, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
- Raport Konsultativ – Llogaritja e Kostos së Blerjes me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar më datën 24 shkurt 2016;
- Raport Konsultativ - Llogaritja e MAR-it të OST/OT , i publikuar më datën 24 Shkurt 2016;




- Përgjigjet ndaj Komenteve - Shqyrtimi i dhjetë i tarifave të energjisë elektrike SHTE10, i publikuar me datën 31 mars 2016.
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga OST/OT për vitin relevant rregullativ SHTE10 janë **22,369,218** euro.
- III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për OST/OT do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore, sipas Rregullës për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit dhe tregut.
- IV. Të Licencuarit për OST/OT duhet t'i përgatisin dhe dorëzojnë për aprovim ZRRE-së ngarkesat për shfrytëzim të sistemit të transmisionit, të përcaktuar në MAR-in këtij vendimi para vitit relevant tarifor.
- V. Ngarkesat e propozuara nga OST/OT duhet të jenë në përputhje me Metodologjinë e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Rrjetit të Sistemit të Transmisionit (TNUOS), Metodologjinë e Ngarkesave të Operatorit të Sistemit dhe Metodologjinë e Ngarkesave të Operatorit të Tregut të aprovuara nga ZRRE .
- VI. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të përkthimeve, do të mbisundojë versioni i gjuhës shqipe.
- VII. Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga KOSTT-i duke filluar nga 1 prilli 2016 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.
- Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar,


Arsim Janova, anëtar,


Qemajl Mustafa anëtar,


Besim Sejfi anëtar.

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.